



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:147194

Datë: 03.07.2024

Numri i dokumentit: 05890510

C.nr.1477/20

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, me praktikanten gjyqësore M.D. në çështjen juridiko kontestimore të paditëses KEDS, me seli në Prishtinë Zyra Ligjore në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson V.C. nga Prizreni, zyrtar ligjor pranë të njëjtit, kundër të paditurit Y.I.T. me vendbanim në Prizren, për shkak të kompensimit të demit material, vlera e kontestit 6,946.46 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 04.06.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses KEDS me seli në Prishtinë.
- II. DETYROHET** i padituri Y.I.T. me vendbanim në Prizren, që në emër të kompensimit të demit material të shkaktuar për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, t'ia paguajë paditëses shumën prej 6,946.46€, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 29.07.2020 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET** i padituri, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 60 euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësja-KEDS me seli në Prishtinë Zyra Ligjore në Prizren, përmes të autorizuarve të saj pranë kësaj gjykate me datë 29.07.2020, ka parashtruar padi për kompensim dëmi material kundër të paditurit Y.I.T. me vendbanim në Prizren, duke theksuar se sipas kalximit penal të Gjykatës Themelore në Prizren të datës 11.07.2020 ku çështja është në shqyrtim penal dhe akima nuk është përfunduar sipas çështjes penale P.2520/16 , i padituri me qëllim që ti sjellë vetes pasuri të kundërligjshme shfrytëzon energjinë elektrike me njuhësorin elektrik nr.17664932 i cili pas shqyrtimit në qendrën e kalibrimit është konstatuar se njuhësorei është manipuluar ka gjurmë të gërvishjes e nr. Në numrator ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, këtu paditëses i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 6,946.46 €, dhe meqenëse i padituri nuk ia bërë pagesën e demit të shkaktuar paditëses, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurin ta paguaj detyrimin.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 04.06.2024 përfaqësuesi i autorizuar i paditëses V.C. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se i padituri i ka shkaktuar dëm KEDS në shumën prej 6946.46 euro, ku bazë për këtë është procesverbali me nr.7544 të datës 20.05.2016 si dhe foto dokumentacioni i bashkangjitur në këtë procesverbal si në provë në këtë procedurë të cilat janë të kalkukuara në përputhje në procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike të miratuar në ZRE. Gjithashtu ka theksuar se nga procesverbali me nr. 0640662 i datës 25.04.2016 nga nënshkrimi i të paditurit mbi këtë procesverbal vërtetohet se ei njeiti ka qenë shfrytëzues i njuhësorit elektrik. Andaj, mbi këtë bazë i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta miratoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar në shumën 60 euro në emër të taksës për padi.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 04.06.2024 i autorizuari i të paditurit ka deklaruar se mbes në tërësi në të gjitha pretendimet dhe i rikujtoj gjykatës se këtu paditësi nuk ka arrit të siguroj bazën e padisë pasi që kemi aktvendim nga Departamenti i Divizionit Penal ku thuhet se kjo çështje ka arritur parashkrim absolut. Ekspertiza e ekspertit e cila u administrua në provat e shqyrtimit gjyqësor të kësaj seance në mënyrë të qart e cek përgjatë shrytëzimit se a e ka shfrytëzuar këtu i padituri nuk ka pasur manipulim nga ana lidhur me procesverbalet dhe kalkulimin e humbjeve ku pretendon këtu se pala e paditëse, ne dhamë vërejtjet tona, provat janë të njëanshme dhe se për neve është e rëndësishme koha kur është shkaktuar dëmi baza e padisë që për neve është e parashkruar, në seancën e sotme dhe i propozoj gjykatës që të refuzoj padinë e paditësit në tërësi si e pa bazuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vlerësimit dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar provat si në vijim: Kallëzimi Penal i parashtuar nga KEDS pranë Prokurorisë Themelore në Prizren CMS-K/4374 të datës 11.07.2016; lexohet procesverbali – raport mbi ndërrimin dhe heqjen e njuhësorit elektrik me nr.0640662 e dt. 25.04.2016; lexohet procesverbali i kontrollit detal të njuhësorit me nr.02 4544 e dt. 20.05.2016; bëhet shikimi i 24 fotografive; kalkulimin e rikthimit të humbjeve me numrin e rastit 55215 të datës 20.05.2016 të lëshuar nga KEDS-i; faturën me numër DPZ16HP10836 të datës 23.05.2016; lexohet procesverbali i shqyrtimit kryesor përpiluar në Gjykatën Themelore në Prizren Divizioni Penal P.nr.2520/16, PP.nr.1962/16 me datë 05.04.2022; lexohet procesverbali i shqyrtimit kryesor përpiluar në Gjykatën Themelore në Prizren Divizioni Penal P.nr.2520/16, PP.nr.1962/16 me datë 07.06.2022; lexohet procesverbali i shqyrtimit kryesor përpiluar në Gjykatën Themelore në Prizren Divizioni Penal pa numër, me datë 28.12.2021; lexohet procesverbali i shqyrtimit kryesor përpiluar në Gjykatën Themelore në Prizren Divizioni Penal P.nr.2520/16, PP.nr.1962/16 me datë 30.11.2021; lexohet ekspertiza, punuar nga eksperti gjyqësor i elektroteknikës M.Gj. nga Prizreni me numër 014/21 të datës 23.3.2021, sipas udhëzimit të Gjykatës Themelore në Prizren me lëndën me numër P.nr.2520/16 dhe bëhet shikimi i 6 fotografive si dhe lexohet procesverbali, të cilat janë pjesë përbërëse e ekspertizës.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palës ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 7 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 06/L-003 për Procedurën Kontestimore, tani e tutje referuar si “LPK”, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së

bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është **në tërësi e bazuar**, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga leximi i Kallëzimi Penal i parashtuar nga KEDS pranë Prokurorisë Themelore në Prizren CMS-K/4374 të datës 11.07.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se i ndaj të paditurit është parashtruar kallëzim penal për shkak se prej datës së pa vërtetuar e deri më datë 25.04.2016 me qëllim që ti sjellë vetit pasuri të kundërligjshme, ka penguar matësin e shpenzimit të energjisë nga regjistri i saktë pa autorizim nga KEDS si furnizues i autorizuar, përkatësisht ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, ndërsa e dëmtuara këtu paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS me seli në Prishtinë – Zyra Ligjore në Prizren për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko- civil.

Nga leximi i procesverbali i kontrollit detal të njuhësorit me nr.02 4544, e dt. 20.05.2016, gjykata vërtetoi faktin se njuhësori elektrik pllombat i ka të manipuluar, të hapura dhe prepë të mbyllura, në mbrendi të njuhësorit komisioni ka vërejtur se numëruesi i njuhësorit është i manipuluar.

Nga shikimi i 24 fotografive, gjykata vërtetoi faktin e njuhësorit elektrik.

Nga kalkulimin e rikthimit të humbjeve me numrin e rastit 55215 të datës 20.05.2016 të lëshuar nga KEDS-i, gjykata vërtetoi faktin se me energjinë e shpenzuar me anë të anashkalimit të matjes nga i padituri, paditëses i është shkaktuar dëmi në vlerë prej 5,645.00 euro, e cila faturë përmban llogarinë për 22 ditë.

Nga leximi i faturës me numër DPZ16HP10836 të datës 23.05.2016, e lëshuar nga paditësja, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja në emër të rikthimit të humbjeve të paditurit i ka faturuar detyrimin prej 6,946.46€, për periudhën kohore prej 1 muaj, e që ndërlihet konkretisht me periudhën kohore kur i padituri ka shkaktuar veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, e cila vlerë është e njëjtë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga leximi i procesverbalt të shqyrtimit kryesor përpiluar në Gjykatën Themelore në Prizren Divizioni Penal P.nr.2520/16, PP.nr.1962/16 me datë 05.04.2022, gjykata vërtetoi faktin se është aprovuar propozimi i të akuzuarit Y.T. pët ta dëgjuar D.K. si dëshmitar në këtë çështje penale.

Nga leximi i procesverbalit të shqyrtimit kryesor përpiluar në Gjykatën Themelore në Prizren Divizioni Penal P.nr.2520/16, PP.nr.1962/16 me datë 07.06.2022, gjykata vërtetoi faktin se shqyrtimi me prezencë të prokurorit të shtetit, përfaqësuesit të dëmtuarës KEDS, ekspertit të elektros, por pa prezencën e të akuzuarit është shtyrë seanca për ditë tjetër.

Nga leximi i procesverbalit të shqyrtimit kryesor përpiluar në Gjykatën Themelore në Prizren Divizioni Penal pa numër, me datë 28.12.2021, gjykata vërtetoi faktin se nga mos pranimi i ftesës së rregullt për dëshmitarin D.K. seanca është shtyrë sërsht.

Nga leximi i procesverbalit të shqyrtimit kryesor përpiluar në Gjykatën Themelore në Prizren Divizioni Penal P.nr.2520/16, PP.nr.1962/16 me datë 30.11.2021, vërtetohet fakti se është konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e shqyrtimit kryesor andaj është shtyrë për ditë tjetër.

Nga leximi i ekspertizës, punuar nga eksperti gjyqësor i elektroteknikës M.Gj. nga Prizreni me numër 014/21 të datës 23.03.2021, gjykata vërtetoi faktin se eksperti ka konstatuar se njuhësori me numër 17664932 i vitit të prodhimit 1999 është i manipuluar gjegjesisht i dëmtuar dhe sipas procedurave për identifikim dhe parandalim të shfrytëzimit të paaautorizuar është shfrytëzim i paaautorizuar i energjisë elektrike. Në bazë të konstatimeve të hargjimit të energjisë elektrike, kohës së vedosjes së njuhësorit, pagesës së energjisë elektrike, njuhësori me numër 17664932 është njuhësori i manipuluar dhe se shfrytëzimi i paaautorizuar i energjisë elektrike mundë të bazohet në posedim të ketij njuhësori, ndërsa rreth kohës ku pretendohet se ka pasë shfrytëzim të paaautorizuar të energjisë elektrike shifet se nuk ka. Në intervalin kohor gjatë qiramarrësit Y.I.T. nuk ka konstatime se njuhësori nga qiramarrësi është manipuluar., Nga shikimi i 6 fotove konstatohet objekti – restoranti, njuhësori dhe fatura, sipas udhëzimit të Gjykatës Themelore në Prizren me lëndën me numër P.nr.2520/16 ku aktakuza pushohet për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Baza ligjore

Me nenin 136 par. 1. të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Në bazë të kësaj dispozite pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pa kujdesia. Në nenin 140 të po këtij ligji parashihet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*, e në çështjen kontestuese i padituri nuk i ka ofruar gjykatës prova që do të provonin se dëmi ndaj paditëses është shkaktuar pa fajin e tij. Gjithashtu me nenin 14 të LPK-së është paraparë se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryesit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilën i pandehuri është shpallur fajtor”*, e që në çështjen konkrete ekziston që këtu i padituri i cili përmes veprës penale i ka shkaktuar dëm material paditëses.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të cilën e kemi cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në ligj dhe fakte. Gjykata ka vërtetuar se i padituri është përgjegjës për kompensimin e dëmit material këtu paditëses, konform përgjegjësisë në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) të cekur si më lartë, pasi që i njëjti i ka shkaktuar dëmin material paditëses, duke e shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizuar, fakt ky i cili është vërtetuar nga provat e proceduara në këtë çështje kontestimore.

Se i padituri është përgjegjës për kompensimin e dëmit këtu paditësit gjykata e ka vërtetuar përmes Kallëzimit penal parashtruar nga KEDS në Prokurorinë Themelore në Prizren, me numër CMS-K/4374 të datës 11.07.2016, përmes të cilit ndaj të paditurit është parashtruar kallëzim penal për shkak se prej datës së pa vërtetuar e deri më datë 25.04.2016 me qëllim që ti sjellë vetit pasuri të kundërligjshme, ka penguar matësin e shpenzimit të energjisë nga regjistri i saktë pa autorizim nga KEDS si furnizues i autorizuar, përkatësisht ka shfrytëzuar në mënyrë të paaautorizuar energjinë elektrike, ndërsa shuma e dëmit shkaktuar nga ana e paditësit është vërtetuar nga fatura e kalkulimit të rikthimit të humbjeve me numrin e rastit 55215 të datës 20.05.2016 të lëshuar nga KEDS-i, gjykata vërtetoi faktin se me energjinë e shpenzuar me anë të anashkalimit të matjes nga i padituri, paditëses i është shkaktuar dëmi në vlerë prej 5,645.00 euro, e cila faturë përmban llogarinë për 22 ditë, nga fatura me numër DPZ16HP10836 të datës

23.05.2016, e lëshuar nga paditësja, gjykata ua fali besimin dhe vërtetoi faktin se pala e paditur, i ka borxh në lartësinë prej 6946.46 euro paditëses, në emër të dëmit material.

Me nenin 136 par. 1. të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Në bazë të këtij principi pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pa kujdesia. Në nenin 140 të po këtij ligji parashihet *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Në rastin i padituri ka paraqitur padi nga i autorizuari i tij avokat Bekim Parallangaj duke e refuzuar padinë e paditësit pas afatit ligjor, ndërsa në shqyrtime gjyqësore nuk i ka ofruar prova gjykatës që do të provonin se dëmi ndaj paditësit është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa me nenin 245 të po këtij ligji, është paraparë se *“kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër”*. Gjithashtu bazuar në nenin 14 të LPK-së në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryesit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilën i pandehuri është shpallur fajtor.

Kamatëvonesa

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (29.07.2020) , bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse

Shpenzimet procedurale

Vendimi për detyrimin e të paditurit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së, ku gjykata e obligoi palën e paditur të paguajë shpenzimet procedurale këtu paditësit dhe atë për taksën gjyqësore në shumën prej 60 euro.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1477/20 më datë 04.06.2024

Gj y q t a r j a
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.